

VENDIM
Nr. 7, datë 15.1.2026

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI PROJEKTIT
“NDËRHYRJE NË ZONA SPORTIVE DHE LODRA PËR FËMIJË ‘DUA TË LUAJ’”,
BASHKIA FIER**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërhyrje në zona sportive dhe lodra për fëmijë ‘Dua të luaj’”, Bashkia Fier.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Fier.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit “truall”, me një vlerë të përgjithshme prej 193 385 534 (njëqind e nëntëdhjetë e tre milionë e treqind e tetëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e tridhjetë e katër) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 193 385 534 (njëqind e nëntëdhjetë e tre milionë e treqind e tetëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e tridhjetë e katër) lekësh, përballohet nga buxheti i shtetit, llogaria “Fondi i shpronësimeve”, në Bankën e Shqipërisë.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga buxheti i Bashkisë Fier.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin.

8. Agjencia Shtetërore për Shpronësimin kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Fier.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Fier, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Fier për pasuritë e shpronësuara, sipas këtij vendimi.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe të regjistrimit të aktit të kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Fier për pasuritë e shpronësuara, sipas këtij vendimi.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave, Bashkia Fier, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Fier dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË DO TË SHPRONËSOHEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “NDËRHYRJE NË ZONA SPORTIVE DHE LODRA PËR FËMIJË, ‘DUA TË LUAJ’”, BASHKIA FIER

Nr.	Pronari			Të dhënat kadastrale (sipas kartelës së pasurisë)				Vlerësimi për shpronësim			Vlera totale (lekë)	Shënime
	Emri	Atësi	Mbiemër	Zona kadastrale	Numri i pasurisë	Lloji	Sip. totale (m ²)	Sipërfaqja e shpronësuar (m ²)	Çmimi (lekë/m ²)	Vlera lekë		
1	Agron Dhori	Dhori Gori	Mita Mita	8532	1/513	Truall	1432	1,432.00	12,458	17,839,856.00	17,839,856.00	
2	Lili	Taqi	Shkurti	8532	1/512	Truall	1796	1,796.00	12,458	22,374,568.00	22,374,568.00	
3	Erion	Sotir	Shkurti	8532	1/511	Truall	1544	1,544.00	12,458	19,235,152.00	19,235,152.00	
4	Arsino	Marko	Backa	8532	1/1018	Truall	285.6	285.60	12,458	3,558,004.80	3,558,004.80	
5	Urani	Miti	Kule	8532	1/1017	Truall	285.6	285.60	12,458	3,558,004.80	3,558,004.80	
6	Tefla	Miti	Prifti	8532	1/1016	Truall	285.6	285.60	12,458	3,558,004.80	3,558,004.80	
7	Mikail	Miti	Prifti	8532	1/1015	Truall	285.6	285.60	12,458	3,558,004.80	3,558,004.80	
8	Leonora	Miti	Koçi	8532	1/1014	Truall	285.6	285.60	12,458	3,558,004.80	3,558,004.80	
9	Drita Viktori Dhimitraq Argile	Llambi Llambi Llambi	Mici Mici Shkurti Shkurti	8532	1/509	Truall	1560	1,560.00	12,458	19,434,480.00	19,434,480.00	
10	Todi Llambi Erion Lili Urani Leonora Tefla Mikail Vasil Agron Dhori	Taqi Taqi Sotir Taqi Miti Miti Miti Miti Miti	Shkurti Shkurti Shkurti Kule Koçi Bardhi Prifti Prifti Mita Mita	8532	1/591	Truall	891	891.00	12,458	11,100,078.00	11,100,078.00	
11	Naunka Çeljeta Demisa	Trifon Mikail Mikail	Goga Sulo Goga	8532	1/1070	Truall	700	700.00	12,458	8,720,600.00	8,720,600.00	
12	Eugen Natasha Klement Klodeta	Kristaq Gori Gori Ilir	Mino Mino Dhanaj Dhanaj	8532	1/1071	Truall	700	700.00	12,458	8,720,600.00	8,720,600.00	
13	Marjanthi	Naun	Goga	8532	1/1066	Truall	4195	4,195.00	12,458	52,261,310.00	52,261,310.00	
14	Pandeli	Naun	Goga	8532	1/1069	Truall	700	700.00	12,458	8,720,600.00	8,720,600.00	
15	Maksim Vite Klarida Kleantino Dhimiter Pandeli Marjanthi Thoma Najë Athina	Naun Naun Ali Piro Naun Naun Naun Naun Naun Naun Naun	Çepele Rina Goga Goga Goga Goga Goga Goga Goga Goga	8532	1/434	Truall	841	577.00	12,458	7,188,266.00	7,188,266.00	
Shuma totale											193,385,534.00	